



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

**V E N D I M**

Nr. 6 , datë 9.12.2015

**P Ë R**

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR, ME OBJEKT  
“NDËRTIMI I PORTIT TË JAHTEVE”, NË KALANË E TURRËS,  
ISH-KOMUNA SYNEJ, KAVAJË, QARKU TIRANË**

Në mbështetje të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr.111/2012, datë 15.11.2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të vendimit nr.416, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, me propozimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, Këshilli Kombëtar i Ujit

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e lejes për përdorim të burimit ujor, me objekt “Ndërtimi i portit të jahteve”, në Kalanë e Turrës, ish-Komuna Synej, Kavajë, Qarku Tiranë.
2. Ngarkohet Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**EDI RAMA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

Nr. serie 00002

LEJE  
PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR

Nr.prot. 572, datë 9 / 12 / 2015

Miratuar me:

VENDIM TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT

Nr. 6, datë 9 / 12 / 2015

Emri i subjektit: **“Finsec Port” Sh.a.**

I regjistruar si subjekt me këto të dhëna: **Nr. QKR (NIPT): L 31909002 M**

Baseni Ujor: **Ishëm – Erzen.**

Qarku: **Tiranë.**

Bashkia/ Komuna: **ish Komuna Synej, Bashkia Kavajë**

Koordinatat:

<b>Pika 1:</b>	<b>X- 4557 559</b>	<b>Y- 4369 245</b>
<b>Pika 2:</b>	<b>X- 4557 446</b>	<b>Y- 4369 560</b>
<b>Pika 3:</b>	<b>X- 4558 100</b>	<b>Y- 4368 954</b>

Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: **Port Jahtesh**

Prurja mesatare -  $m^3/s$   
Prurja ekologjike -  $m^3/s$   
Sasia e ujit që jepet për përdorim -  $m^3/s$

Vëllimi i rrjedhës së kthyer (nëse ka) **nuk ka**  $m^3/s$  dhe vendi ku rrjedha e kthyer do të shkarkohet **nuk ka**.

Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorura : **Impjanti i pastrimit të ujërave të ndotur.**

Sipërfaqja e tokës me të cilën lidhet përdorimi i ujit (në rastin e ujitjes) (ha): **nuk ka**

Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka): **Në përputhje me kushtet e Kontratës së Konkensionit.**

Periudha e vlefshmërisë: **Në përputhje me afatet e Kontratës së Konkensionit.**

KRYETAR

EDIRAMA



## Kushtet e Lejes

1. Të respektohet qëllimi për të cilin jepet kjo leje;
2. Të respektohen kushtet higjieno – sanitare dhe të mbrojtjes së mjedisit përreth;
3. Përdoruesi i ujit është i detyruar të vendosë matës ujit me shpenzimet e veta sipas rregullave që vendosin autoritetet e ujit;
4. Në rastet kur uji përdoret si produkt ushqimor, procedurat e prodhimit duhet të jenë konform rregullave të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;
5. Burimi ujqor të shfrytëzohet nga zotëruesi i lejes;
6. Brenda dy (2) muajve nga pajisja me leje, subjekti duhet të fillojë veprimtarinë për të cilën është pajisur me leje;
7. Leja ndalohet t'i transferohet një subjekti tjetër pa miratimin e organeve kombëtare të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujqore;
8. Të mos kryhen veprime që sjellin drejtpërdrejtë ose si pasojë, dëmtimin e burimit ujqor;
9. Subjekti të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontrolleve nga autoritetet përkatëse;
10. Subjekti të paraqesë çdo informacion, dokument dhe të japë çdo shpjegim lidhur me mënyrën e përdorimit të burimit ujqor;
11. Për shkeljen e kushteve të lejes, do të merren masa në përputhje me Kreun XIX të Ligjit nr.111/2012;
12. Zotëruesi i lejes paguan shpenzimet administrative dhe tarifën për ujin e shfrytëzuar, bazuar në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave.

## Ndryshimi ose anulimi i lejes

Kjo leje mund të ndryshohet pjesërisht ose të anulohet plotësisht, para mbarimit të afatit të përcaktuar, kur:

1. Përfituesi i lejes shkel njërin nga kushtet e parashikuara më sipër;
2. Organi kompetent për nxjerrjen e lejes bën azhornimet përkatëse lidhur me burimin konform ndryshimit të planeve të burimeve ujqore, ndryshim i cili prek edhe burimin ujqor, objekt i kësaj leje;
3. Kushtet e dhënies së lejes kanë ndryshuar;
4. Burimi ujqor është drejt shterimit;
5. Aktiviteti që ushtrohet, bazuar në lejen e dhënë, është shkak i ndotjes së burimit ose mjedisit;
6. Në qoftë se për shkak të forcave madhore ndodhin ndryshime në prurjen, cilësinë, kufijtë e burimit, etj, dhe këto ndryshime sjellin pamundësinë e përdorimit të tij nga zotëruesi i lejes, ky i fundit ka të drejtë t'i drejtohet organit kompetent, që i ka dhënë lejen, për ta anuluar atë;
7. Ka ndryshime të legjislacionit përkatës në fushën e ujërave dhe që prekin drejtpërdrejtë kushtet e kësaj leje.




# POZICIONIMI I STRUKTURES SE PORTIT TE JAHTEVE NE ZONEN "KALAJA E TURRES"

X=368613.15  
Y=4556440.62 UTM

X=370413.15  
Y=4556440.62

HARTA TOPOGRAFIKE E KONÇENSIONIT TE PORTIT TE JAHTEVE  
ZK.2909;INDEKSI I HARTES. K-34-99-(143-C);(159-A)  
(KALAJA E TURRES -SYNEJ - KAVAJE)



- PIKA Nr.1; X=4557 559  
Y=4369 245
- PIKA Nr.2; X=4557 446  
Y=4369 560
- PIKA Nr.3; X=4558 100  
Y=4368 954

**FINSEC PORTI S.H.A.**  
Topograf Osman Topaj  
Rr. George W Bush, Kulla 50  
TIRANE - ALBANIA

X=4557300  
Y=4368700  
X=368613.15  
Y=4555340.62 UTM

SISTEMI KOORDINATIV: SHITETROR  
SISTEMI LARTESIVE: KUOTA ABSOLUTE

X=370413.15  
Y=4555340.62

4557300  
4370500